



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 34
Prishtinë, më 19 dhjetor 2018, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Mërgim Lushtaku, Albert Kinolli, Etem Arifi, Avdullah Hoti, Emilija Rexhepi, dhe Ali Lajçi.

Munguan: Faton Topalli, Andin Hoti, Valon Ramadani dhe Verica Qeraniq.

Stafi mbështetës: Antigona Ibraj, Mehmet Simnica, Ajet Avdullahu dhe Endrit Rustemi.

I ftuar: Uran Ismajli, ministër i Ministrisë së Shëndetësisë.

Pjesëmarrësit tjerë: Naim Bardiqi, Kushtrim Shkodra, Mentor Sadiku, Nexhip Sheholli dhe Deme Rexhepi nga MSH. Vjoleta Smajlaj, Florian Beqiri, Fatlinda Ramosaj, Bujar Bajraktari dhe Emine Fazliu nga ZKA-ja. Donika Voca nga KTV dhe Saranda Ramaj nga “Koha”.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.12.2018;**
- 3. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017;**
- 4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për Pasqyrat Financiare për Qëllime të Veçanta për projektin “Shëndetësia Kosovare” për periudhën e përfunduar më 31.12.2017;**
- 5. Shqyrtimi i raportit të Auditimit të përfundimit të performancës “Lista Esenciale e Barnave”;**
- 6. Të ndryshme.**

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që pika e katërt të hiqet nga rendi i ditës për shkak se siç ishte informuar nga zyrtarët e Zyrës Kombëtare të Auditimit, se ky raport është i performancës dhe se marrëveshja me Projektin e Bankës Botërore dhe Zyrës Kombëtare është që letërmënaxhmenti t' i dorëzohet vetëm menaxhmentit të projektit i cili është financuar nga Banka Botërore.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.12.2018

Procesverbali i mbledhjes, të mbajtur më 13.12.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017

Driton Selmanaj i njoftoi anëtarët e Komisionit dhe të pranishmit që deputet raportues për Raportin e Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Shëndetësisë është deputeti Albert Kinolli të cilit edhe i dha fjalën.

Albert Kinolli tha që opinioni i auditimit për PFV për vitin 2017 është Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes. Theksimi i çështjes është se Auditimi ka nxjerrë në pah se në regjistrin kontabël të SIMFK nuk ishte regjistruar e gjithë pasuria e blerë nga MSH në vitin 2017. Vlera e pasurisë (investimeve në vijim) prej 3,323,368€ nuk ishte regjistruar. Për këtë vlerë të paregjistruar nuk është deklaruar pasuria e MSH për vitin 2017. Planifikimi i buxhetit nuk ishte bërë bazuar në analiza të mirëfillta dhe reale. Kjo ka shkaktuar nevojë që gjatë vitit 2017 të bëhen shumë përshtatje buxhetore nëpër kategori ekonomike. Ai tha që edhe në fushën e të hyrave janë evidentuar disa mangësi duke përfshirë, mospërputhje në mes kërkesës dhe shtypjes së banderolave; dhe vonesa në shqyrtimin e aplikacioneve për licencë importi të produkteve dhe pajisjeve mjekësore nga AKPM. Ai gjithashtu tha që në MSh vazhdojnë të mbahen gjithsejtë shtatë pozita me ushtrues detyre, të cilat kishin tejkalluar afatin e lejuar ligjor për mbajtjen e pozitës në këtë formë. Ai tha që kategoria e shpenzimeve që ka të bëjë me mallra dhe shërbime dhe investime kapitale mbeten fusha ku nevojiten përmirësime të konsiderueshme për shkak se auditimi ka identifikuar mangësi. Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 4,266,793€. Lidhur me zbatimin e rekomandimeve ai tha që nga 26 rekomandime të dhëna, 7 rekomandime janë zbatuar, 2 ishin në proces të zbatimit dhe 17 mbesin të pazbatuara.

Uran Ismajli tha që raporti ka pasur shumë të gjetura dhe gjeturat janë paraqitur ashtu siç është edhe gjendja reale. Ai tha që si ministri kemi pasur probleme në shqyrtimin e aplikacioneve, në shtypjen e banderolave, pastaj kemi pasur probleme edhe në pjesën e të hyrave etj. Në aspektin menaxherial ai tha që kanë pasur shumë pozita me ushtrues detyre, kjo për shkak se për disa pozita, disa persona në Ministrinë e Shëndetësisë janë suspenduar për shkak të procedurave gjyqësore. Edhe të furnizimi me barna ka pasur probleme në gjithë zinxhirin e furnizimit me barna. Ai tha që ka ndaluar të gjitha kontratat e paligjshme. Lidhur me zbatimin e rekomandimeve ai tha që kanë bërë planin e veprimeve dhe se tashmë disa rekomandime janë zbatuar dhe disa janë në zbatim e sipër.

Ali Lajçi tha që nga paslufta më këtë ministri ka pasur një kaos në menaxhim dhe ministri siç duket nuk ka arritur ta tejkalojë këtë. Ai tha që sistemi i pranimit dhe shpërndarjes së barnave nuk ka qenë koherent dhe ai përmendi një deklaratë të ministrit ku ai kishte thënë se ka ndaluar një korrupsion prej 6 milionë eurove.

Avdullah Hoti tha që të gjeturat janë shqetësuese, por që vlerëson veprimet e ndërmarra të ministrit për t'i adresuar këto çështje. Ai tha që është kujdesur të gjej nëse Raporti i Auditimit tregon që ku janë shpërdoruar 6 milionë euro, të cilat dalin nga deklaratimet publike të ministrit para disa ditëve. Ai tha që pret që nga ministri të ndërmarrë veprime për të parë se nga kush janë keqpërdorur mbi 6 milionë euro, pasi që nëse ai nuk e bën këtë, të tjerët duhet të ndërmarrin veprime ligjore karshi jush për deklarime të papërgjegjshme, për dëmtim të kredibilitetit të mjekëve, të zyrtarëve që janë në ministri dhe të tjerëve. Për çdo shkelje që është bërë në të kaluarën, tani janë organet përkatëse për adresim dhe duhet të jemi të përgjegjshëm kur flasim publikisht, sepse kur thua 6 milionë eurosh janë shpenzuar në afëra korruptive, neve sot këtu duhet me na e thënë se kush është personi i përfshirë në këtë aferë korruptive dhe në cilën kohë dhe cila është shuma e mjeteve që është keqpërdorur.

Uran Ismajli tha që nëse me vetëdije të plotë porositen barna jashtë kontratës ose që bari është shumë herë më i shtrenjtë sesa në lokalin privat, ai tha që nuk e din se si quhet ndryshe nëse jo korrupsion. Ai tha që nuk është prokuror për t'i ndjekur ata që kanë keqpërdorur dhe se këtë duhet ta bëjnë organet e ndjekjes. Ai tha që është mirë që çdo kush duhet të distancohet nga aferat korruptive!

Driton Selmanaj tha që nuk jemi këtu për të cilësuar nivelin e krimit ose të korrupsionit dhe që ministri duhet që neve të na tregojë vetëm nëse për gjerat konkrete i ka adresuar apo jo në organet përkatëse. Ai tha që bari që tashmë blihet me 3.4€, është blerë me 32€, mirëpo që para tij është blerë me 96€. Ai tha që të mos lëshohemi në cilësime lidhur me diferencat sepse janë institucionet e tjera që duhet dhënë përgjigje se pse kanë ndodhur dhe si kanë ndodhur.

Uran Ismajli tha që Raporti i Auditimit nuk ka emër dhe mbiemër dhe vetëm i adreson çështjet dhe këtë gjë po e bën edhe ai. Ai tha që nuk po përmendi emra dhe mbiemra dhe vetëm po përmendi gjëra që kanë ndodhur. Unë nuk po ia lë dhe asnjëherë nuk ia kam lënë fajin një personi, asnjëherë nuk ia kam ngritur gishtin vetëm një personi. Ne kemi blerë barna 6 milionë euro më lirë se vitin e kaluar, pra barnat janë të njëjta të listës esenciale nuk kemi shpikur barna të rinj.

Driton Selmanaj tha që te raporti i ekzekutimit të buxhetit ka pasur një mbivlerësim prej 409 mijë euro kurse te avancat kemi një nën deklarin prej 502 mijë euro. Ai pyeti ministrin se a vazhdojnë këta persona që kanë bërë këto pasqyra të ushtrojnë funksionin e njëjtë. Ai gjithashtu tha që më herët është paguar 3 milionë euro për Insulinë dhe është konsideruar që janë plotësuar nevojat, kurse tani paguhet 5 milionë euro dhe nuk plotësohen nevojat. Ai pyeti ministrin se a është shtuar numri i pacientëve, është shtrenjtuar ky bari apo çka ka ndodhur?

Uran Ismajli tha se kemi vërejtur se gjatë viteve të kaluara avancat janë keqpërdorur në masë të madhe, ose barazimi i tyre nuk ka ndodhur, sistemi i avancave është goxha i thjeshtë, por edhe vërehet se nëse nuk është bërë mbyllja e tij, mbeten gjurmët. Nuk kanë qenë kërkesat reale atë e gjeni edhe në raportin e auditorit që kërkesat reale të institucioneve nuk janë të paraqitura drejt, në blerjen e bëjmë në bazë të kërkesave të Institucioneve Publike, nuk bëjmë blerje pse ne kemi menduar se kemi kaq persona sepse ata i marrin edhe në mjekësinë primare.

Përfundim

KMFP vendosi që Raportin e Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të audituara të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2017 të mos e adresoj për Seancë Plenare.

4. Shqyrtimi i raportit të Auditimit të performancës “ Lista esenciale e barnave”

Driton Selmanaj tha që konkluzionet e Raportit të Auditimit të performancës së listës esenciale të barnave janë që MSH, FSSH dhe SHSKUK nuk e menaxhojnë mirë Listën Esenciale të Barnave(LEB), duke rezultuar me mungesë të barnave në pjesën më të madhe të kohës dhe si pasojë pacientët duhet t'i blejnë vetë ato. LEB nuk është përditësuar asnjëherë gjatë 5 viteve të fundit dhe për pasojë ne kemi identifikuar një numër të madh të barnave, pjesë e kësaj liste që nuk janë porositur nga asnjë klinikë në QKUK ose SP (rreth 30%) dhe në të njëjtën kohë janë identifikuar lloje të ndryshme të barnave që janë kërkuar dhe blerë nga spitalet por që nuk janë pjesë e LEB. Barnat vitale të cilat shpëtojnë jetë, për arsye të buxhetit reduktohen pa ndonjë kriter. Procesi i planifikimit nuk ka formë standarde të llogaritjes. Vonesat në shpërndarje në shumë raste janë arsye pse barnat nuk janë në dispozicion me kohë për pacientin. Po ashtu, vonesat në fillimin e procedurave të prokurimit kanë ndikuar që të ketë mungesë të barnave. MSH dhe FSSH nuk kanë filluar me kohë procedurat e prokurimit për kontratat të cilat kanë skaduar dhe si pasojë furnizimi me barna për pacientët nuk ishte me kohë. Edhe pse Sistemi Informativ Shëndetësor ishte i programuar të përfshinte edhe informata rreth barnave siç janë: sasi të planifikuara, të aprovuara dhe stoqet, ky sistem nuk është plotësisht funksional. Funksionalizimi i këtij sistemi do të afronte informata për palët përgjegjës dhe nivelin e përgjegjësisë së tyre brenda sistemit.

Uran Ismajli tha që kanë filluar një proces të revidimit të LEB, por që janë ekspozuar edhe problemet e tjera që cilat paraqiten. Revidimin e listës esenciale jemi duke e bërë me OBSH-në. Kemi pasur ekspertë të tyre, të cilët kanë ardhur dhe na kanë ndihmuar. Kemi formuar komisionin dhe nën komitetet për revidim të listës. Ai tha që për fat të keq ka gjetur një situatë kaotike, të cilat kanë rezultuar në shpenzime shtesë të pacientëve. Ai tha që kanë bërë punë të mëdha dhe këto do të shihen në raportet e ardhshme të auditimit.

Emilija Rexhepi tha se e kuptojë problemin që ballafaqohet i tërë sistemi shëndetësor në Kosovë që nga paslufta, e në veçanti problemet me listën esenciale të barnave. Kjo po ndodhe, nuk e dije për shkak të mungesës së barnave apo për shkak të shpërndarjes jo të mirë në mes nivelit qendror dhe atij lokal, pra në mes shëndetësisë primare dhe asaj terciare. Pra, shëndetësia primare varet vetëm nga niveli lokal nga Komuna e jo edhe nga Spitalet. Bari i Insulinës edhe pse është në listën esenciale ajo në nivelin lokal blihet në barnatoret private. Shqetësuese mbetet fakti se mjeket në ambulanta i rekomandojnë pacientëve barin për Insuline që të blihet në barnatoret private. Në Prizren barnatorja shtetërore është në gjendje jo të mirë sa i përket furnizimit me barna.

Uran Ismajli tha që në rastin e mjekësisë primare dhe asaj sekondare asnjëra anë nuk i ka kompetencat e plota. Planifikimin e bënë ministria ndërsa implementimin e bënë komuna. Ai tha ka kërkuar që të bëhet një hulumtim komunë për komunë që të shoh se si është gjendja e mjekësisë

primare, pra se si është gjendja e ambulantave, sa është numri i mjekëve, a i kanë pajisjet e nevojshme për punë etj. Në të ardhmen do të tentojmë të krijojmë një partneritet kontraktual me komunat dhe të ju themi ne do të investojmë kaq, por edhe ju duhet të investoni kaq. Kujdes shëndetësor ka, mirë po është e vështirë sepse kaq shumë kohë ka kaluar dhe ne nuk kemi mundur të krijojmë një sistem të qëndrueshëm shëndetësor.

Emilija Rexhepi po ashtu theksoi se pas Prishtinës, Prizreni është qendra e dytë sa i përket tretmanit numrit të madhe të pacienteve që vuajnë nga Kanceri. Pra, që tretmani të bëhet edhe në nivel të Spitalit të Prizrenit.

Mergim Lushtaku, pasi nuk pati diskutim në këtë pikë të rendit të ditës, e mbylli me këtë:

Përfundim

KMFP vendosi që Raportin e Auditimit të performancës “Lista Esenciale e Barnave” të mos e adresoj për Seancë Plenare. Rekomandimet do t’i adresohen vetëm Ministrisë së Shëndetësisë.

5. Të ndryshme.

Nuk pati diskutim në këtë pikë të rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Driton Selmanaj